Këshilla të rëndësishme

- Në qoftë se merrni vendim të niseni jashtë shtetit, siguro sa më shumë numra telefoni dhe adresa të njerëzve që njihni.
- Gjithmonë kontaktoni Ambasadën e atij shteti në Tiranë përpara se të niseni.
- Mësoni çdo gjë rreth ofertës që ju bëjnë .
- Konsultohu me prindërit ose me një njeri të besuar rreth ofertës.
- Mos nënshkruaj asnjë ofertë pune që ti nuk e kupton.
- Merr adresën e ambasadës Shqiptare në vendin ku do të shkoni.
- Konsultohu me organizata që mbrojnë të drejtat e njeriut.
- Sigurohu që institucioni është i ligjshëm.
- Lëri prindërve, shokëve, të afermëve adresën dhe numrin e telefonit ku ata mund të kontaktojnë, një kopje të kontratës së punës ose shkollës, emrat e adresat e njerëzve që do të udhëtojnë me ty.
- Para se të nisesh bëj një kopje të faqes së parë të pasaportës e vizës dhe lerja atë të afërmve.
- Mos ia jepni pasaportën tuaj kujtdo.

MBRO VETEN
QË SHOQËRIA
TE MENDOJË PËR TY.

LIRIA DHE PROGRESI
NUK VIJNË DUKE HESHTUR!

Shoqata "Gratë e Kuçovës në Fokusin e Zhvillimit" me mbeshtetjen e Nismës Shqiptare: Koordinimi i Veprimeve Kundër Trafikimit Njerëzor (KVKTN) dhe USAID, ka ndërmarrë iniciativen për zbatimin e projektit "Aksion kundër trafikimit njerëzor ne Kuçovë". Qellimi i projektit është Parandali i Fenomenit të Trafikimit Njerëzor në zonën e Kuçovës.

BASHKOHU ME NE PËR T'I THËNË

STOP

TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Adresa:
Lgj. Llukan Prifti, Blloku nr.2,
Kuçovë-Shqipëri
00355 (0) 3 112537
00355 (0) 69 2612047
elsarafaeli@yahoo.com

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN

Projekti "AKSION Kundër Trafikimit Njerëzor në Kuçovë"

Stop Trafikimit Njerëzor

Mbroni Jetën!

GRUAJA E KUÇOVËS NË FOKUSIN E ZHVILLIMIT

Nisma Shqiptare:
KVKTNJ
Koordinimi i Veprimeve Kundër Trafikimit Njerëzor

Trafikimi i Qenieve Njerëzore konsiderohet si forma moderne e SKLLAVËRISË

Trafikimi i Qenieve Njerëzore përfshin:

- Rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen, pritjen e personave nëpërmjet:
- Kërcënimit përdorimit të forcës, të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit:
- Shpërdorimit të detyrës apo përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, dhënies apo marrjes së pagesave
- Përfitimeve, për të marrë pëlqimin e një personi, që kontrollon një person tjetër.

Me qëllim: shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës apo shërbimeve të detyruara të skllavërimit.

(Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar)

Metodat e rekrutimit

- Mashtrimit për punësim.
- Premtim për fejesë apo martesë të rreme.
- Premtime për studime jashtë vendit.
- Premtim për një jetë më të mirë.

ETJ

Trafikimi i personave ka natyrë kriminale, është kërcenim për shëndëtin publik, zhvillimin ekonomik dhe atë social, e mbi të gjitha është SHKELJE E TË DREJTAVE TË NJERIUT.

Shkaqet e trafikimit

- Niveli i ulët ekonomik
- Niveli i lartë i papunësisë, sidomos i femrave në zonat rurale.
- Vështirësitë për t'u pajisur me viza e emigruar në mënyrë të ligjshme në vëndet e zhvilluara.

- Pozita gjeografike.
- Diskriminimi gjinor e etnik, dhuna në familje
- Mungesa e informimit në lidhje me rrezikun e trafikimit,
- Ndryshimi i sistemit ekonomik-shoqëror, lëvizja e lirë dhe tranzicioni i gjatë e i vështirë:

- Aspirata për një jetë më të mirë dhe mungesa e perspektivave/mundësive.
- Niveli arsimor i ulët sidomos në zonat rurale.
- Paaftësi e organeve të shtetit për të goditur krimin.

- Mungesa e besimit për shkak të korrupsionit.

Pasojat e trafikimit

- Shkelje e të drejtave të njeriut.
- Abuzim emocional dhe psikologjik
- Dhunë fizike
- Përdhunim
- Izolim ndaj çfarëdolloj kontakti me shokët dhe të afërmit.
- Marrja e dokumentave për ta mbajtur në gjëndje ilegale.
- Cenim personaliteti
- Kërcënim i personit dhe / ose familjes
- Drogim ose vrasje të vetë viktimës
- Semundje seksualisht te transmetueshme

Profili i viktimës

Viktimat mund të jenë vajzat, gratë dhe fëmijët

- Me nivel të ulët arsimor
- Me gjendje ekonomike shumë të vështirë
- Me prindër të divorcuar.
- Me përjetime të dhunës në familje dhe jashtë saj.

- Me familje me shumë anëtarë.
- Femijët jetimë dhe pa përkrahje.
- Në kërkim të një jetë më të mirë.

Profili i trafikantit

Trafikanti është një person në dukje normal, por në të vërtetë përban disa veçori:

- Ai mund të ofrojë zgjidhje të shpejtë dhe të lehtë të problemeve
- Ai mund të kerkojë nga ju sjellje dhe veprime të sikleteshme, që nuk ju bëjnë të ndiheni rehat/vetvetja.

- Ai hiqet si një person që ushtron një biznes të ligjshëm.
- Ai paraqet si një person tolerant dhe i besueshëm.

- Ai i premton një martesë të lumtur.
- Ai nuk është gjithnjë i huaj, por një person i njohur si i afërm, komshi, shokë / shoqe.

Nëse edhe ti hesht,
Kush mbetet të flasë për ty?!
Te gjithë mund
Të bëjmë gjithçka